



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 29 dhjetor 2014, në mbledhjen e XII-të
(dymbëdhjetë) të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.10'.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht Afrim Shabani, Bahri Blakçori, z. Islam Revuçi Fidan Rekaliu , Haki Rudari, , Kadri Avdiu, Kumrie Hoti, Mynavere Abdullahau – Krasniqi, Naim Çunaku dhe Rafet Llapashtica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimarrje.

1. Miratimi i rendit të ditës

z. Haki Rudari, theksoi, në mbledhjen e fundit të Kuvendit kolegja Adelinë Stublla, ka propozuar që lehonat të ndihmohen me nga 100 € dhe është vendosur që kjo çështje të përfshihet në rend dite në mbledhjen e radhës. Duke u bazuar se nuk është vepruar në këtë mënyrë, propozoj që kjo çështje të përfshihet në rendin e ditës të mbledhjes së sotme.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, në mbledhjen e kaluar mbi bazën propozimit të Grupit të këshilltarëve të PDK-së por edhe me mbështetjen e grupeve tjera të këshilltarëve ka mbet që në këtë mbledhje të na jepet një njoftim lidhur me çështjen e lokacionit për ngritjen e obeliskut të Heroit Afrim Zhitia, kjo çështje nuk është përfshirë në rendin e propozuar të ditës andaj nuk jam në dijeni se Drejtoria kompetente a e ka përgatitur njoftimin përkatës apo jo.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, sa i përket propozimit për ndihmë financiare lehonave, unë kam biseduar me drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave dhe jam informuar se tani për tani nuk mund të bëhet asgjë ngase projektbuxheti për vitin 2015 është miratuar në Kuvendin e Komunës dhe sot pritet të miratohet edhe Ligji për buxhetin e vitit 2015 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, nga kjo nuk ka mundësi ligjore të vendoset për çështjen e cekur deri në rishikimin e buxhetit për vitin 2015, andaj kjo është arsyeja përse nuk është përgatitur propozimi përkatës.

Sa i përket obeliskut të Heroit Afrim Zhitia, sot kam biseduar me drejtorin e Drejtorisë së Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë, i cili tha se për çështjen e cekur

nuk kanë përfunduar procedurat gjyqësore dhe nuk ka të shtoj asgjë dhe nuk ka informatë shtesë, përveç asaj çfarë ka sqaruar në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa.

z. Afrim Shabani, theksoi, sa i përket stimulimit të shtatzënave me nga 100 €, jam i mendimit se askush prej neve nuk është kundër këtij propozimi, mirëpo duke u bazuar se shumë gra të Komunës së Podujevës lindin në Prishtinë, konsideroj se kjo çështje kërkon analizim më detaj, pra të përcaktohet që përfituese të jenë vetëm gratë të cilat lindin në Podujevë.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, është e nevojshme të ndihmohet kategoria e cekur, mirëpo u sqarua se për destinimin e cekur mungon buxheti, andaj konsideroj se për këtë çështje mund të diskutojmë kur të shqyrtohet rishikimi i buxhetit për vitin 2015.

z. Naim Çunaku, theksoi, jam i mendimit se stimulimi i shtatzënave me nga 100 € është propozim siç tha Dr. Afrim Shabani, nuk mund të jetë askush kundër këtij propozimi, mirëpo konsideroj se është paksa e vonuar meqë kjo çështje nga ana ime do të kishte mbështetje pa rezervë në fazën kur do të shqyrtohej buxheti i Komunës, mirëpo pavarësisht nga kjo iniciativa është që të mbështetet por në kohën dhe momentin e duhur. U përmend se cila kategori mund të jetë përfituese për këtë duhet debatuar kur kjo çështje shtrohet në rend dite, mirëpo konsideroj se nuk mund të ndahet një banore e Komunës së Podujevës pavarësisht se a lind në Podujevë apo Prishtinë.

z. Afrim Shabani, theksoi, mendimin tim e bazova në shërbimet e cilësisë së njëjtë si në Podujevë ashtu edhe në Prishtinë dhe në rrethanat kur ndërron shërbimin e cilësisë së njëjtë, atëherë konsideroj se ajo kategori duhet të përjashtohet nga shpërblimi i cekur.

z. Naim Çunaku, theksoi, është e drejtë themelore e një nëne që ta zgjedh vendin se ku dëshiron të lindë.

z. Mynavere Abdullahu, theksoi, e mbështes në parim dhe shtoi, u sqarua mjaftë mirë se kjo çështje ka mundur të diskutohet në shtator të këtij viti kur është miratuar projektbuxheti për vitin 2015. Mirëpo unë kam vërejtje për drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ngase kjo kërkesë është shtruar edhe më parë dhe drejtori përkatës është dashtë të jep përgjigje dhe arsyetimin me shkrim këshilltares e cila e ka bërë kërkesën, ngase sikur të ishte vepruar në këtë mënyrë tani nuk do të diskutonim për këtë çështje.

z. Haki Rudari, theksoi, gjatë diskutimeve u përmend se kjo çështje është e vonuar, mirëpo jeni në dijeni se nga kolegja ime propozimi është bërë, nëse nuk gaboj, në mbledhjen e katërt të Kuvendit, andaj në njëfarë mënyre është papërgjegjësi e Ekzekutivit, por tash po rezulton se është papërgjegjësi edhe e ne këshilltarëve ngase propozimet e kolegëve nuk i marrim parasysh e tash themi se jemi vonuar.

Përndryshe pajtohem me parafolësen se në pyetjen e parashtuar, drejtori i Drejtorisë përkatëse është dashtë të jep përgjigje me shkrim.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, pajtohem se në të gjitha pyetjet e këshilltarëve drejtorët e Drejtorive përkatëse duhet të japin përgjigje varësisht nga ajo se përgjigjja a kërkohet të jepet gojarisht apo në formë të shkruar.

z. Kadri Avdiu, theksoi, është e qartë se tashmë jemi vonuar për shqyrtimin e propozimit për stimulimin e shtatzënave me nga 100 €, kuptohet e mbështesim

këtë propozim dhe konsideroj se nuk ka asgjë të keqe që kjo çështje të debatohet edhe në Kuvend.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, në kuptimin e diskutimit të parafolësit mund të obligohet drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale që parashtrueses së kërkesës, nesër para fillimit të mbledhjes së Kuvendit t'i jep përgjigjen në formë të shkruar.

z. Naim Çunaku, theksoi, sot edhe nëse votojmë dhe e mbështesim propozimin e cekur, shtrohet pyetja se a kemi mundësi me miratuar vendimin përkatësisht me caktuar një kod buxhetore për mbështetje financiare shtatzënat, këtë mundësi tash për tash nuk e kemi.

z. Islam Revuçi, theksoi, askush nuk është kundër propozimit që shtatzënat të mbështeten në mënyrë financiare, mirëpo mjaftë mirë u sqarua se edhe nëse miratohet vendimi i njëjti nuk mund të zbatohet për shkak të pamundësisë së ndërhyrjes në buxhetin e Komunës, kjo mund të bëhet me rastin e rishikimit dhe atëherë mund të debatohet për propozimin e cekur.

Rendi i propozuar i ditës u miratua me shumicë votash, përkatësisht 10 vota për dhe 1 votë kundër, pa e mbështetur propozimin e z. Haki Rudarit.

2. Shqyrtimi i Ekstraktit të procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa më 13 nëntor 2014

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

3. Propozim Plan i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2015

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, duke u bazuar se jemi në fund të vitit, jam i mendimit se Kuvendit të Komunës i takon që të bëjë një analizë për mos përmbushjen e planit të punës, obligimeve ligjore dhe atyre të Statutit të Komunës, të disa akteve përgjegjës. Kur e them këtë referohem në çështjet për të cilat është dashtë të raportohet në Kuvend në afatet e caktuara. Në këtë kontekst së pari Kryetari i Komunës nuk e ka përmbushur obligimin e vet, pra nuk e ka kryer detyrën e vet e kjo për mua është dobësi.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi nuk ka raportuar fare përkundër faktit se ka qenë një vrasje në zonën kufitare, e të mos flasim për probleme të tjera duke përfshirë aksidentet e shumta në komunikacion.

Kryetari asnjëherë nuk e ka paraqitur në Kuvend raportin për situatën ekonomike – financiare, obligim të cilin është dashtë me përmbush, ka mundur të mos i përmbahet kësaj, por konsideroj se kryesuesi i Kuvendit duhet t'i përkujtoj dhe zyrtarisht, në formë të shkruar, t'i drejtohet Kryetarit të Komunës dhe të gjithë të tjerëve që t'i përmbushin obligimet ligjore sa i përket përgatitjes dhe dorëzimit në Kuvend të çështjeve përkatëse.

Në këtë kontekst përgjegjësinë e bartin edhe shefat e Grupeve të këshilltarëve ngase të njëjtit me kohë është dashtë të kërkojnë që në Kuvend të dorëzohen për shqyrtim raportet dhe çështjet përkatëse.

Bazuar në këtë jam i mendimit se edhe ky Plan i punës nuk do të realizohet, andaj unë jam kundër miratimit të këtij dokumenti.

z. Kadri Avdiu, theksoi, në dy mandatet e fundit jam këshilltar i Kuvendit dhe më vjen mirë që në fund të këtij viti, për herë të parë paraqitet propozimi i planit të punës për një vit vijues, përkatësisht për vitin 2015.

z. Rafet Llapashtica, tha se nuk është respektuar Plani i punës i vitit aktual, i përmenduri nuk ka qenë këshilltar dhe nuk është në dijeni se asnjëherë nuk kemi pas Plan pune të Kuvendit.

Pra e mbështes propozimin e këtij dokumenti në të cilin janë paraparë çështje të caktuara për shqyrtim duke përfshirë edhe afatet përkatëse, mirëpo dihet se ky plan mund të ndryshoj përkatësisht mund të shqyrtohen edhe çështje të tjera sipas nevojës, gjithashtu mund të mbajmë edhe mbledhje të jashtëzakonshme. Përndryshe ky plan i punës ia lehtëson punën edhe kryesuesit të Kuvendit ngase nuk ka nevojë të shkoj nëpër Drejtori Komunale dhe të kërkoj materiale për Kuvend.

Shpresoj se bashkërisht do të angazhohemi dhe do të punojmë për realizimin e këtij Plani të punës.

Për janar 2015 është paraparë pika e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozimeve të Komisionit për emërtimin e rrugëve në territorin e Komunës së Podujevës, kërkoj falje për shmangie nga rendi i ditës, mirëpo lidhur me çështjen e cekur kam parë se në media janë paraqitur disa dilema, unë nuk kam dashtë të lëshohem në polemika të njerëzve që flasin rrugëve rreth propozimeve për emërtimin e rrugëve, por në cilësinë e anëtarit të atij Komisioni duke u bazuar në të dhënat zyrtare e kam dhënë një intervistë dhe me përgjegjësi të plotë mund të them se nga Kryetari i Komunës nuk ka pas ndërhyrje sa i përket propozimeve për emërtim të rrugëve. Unë gjithëherë e them vetëm të vërtetën, në intervistë e kam përmendur se në një rast ka ndërhyrë një drejtor i një Drejtorie komunale, kjo ka qenë e vërtetë dhe nuk e kam mohuar.

Nuk është e vërtetë se është hequr emërtimi i rrugës “ Ilir Kunushefci “ por propozim unanim i Komisionit ka qenë që në një rrugë të renditen tre Heronjtë e Kombit, përkatësisht Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu dhe Ilir Kunushefci, ndërsa kodi i rrugës aktuale “ Ilir Kunushefci “ ka mbetur i zbrazët. Në këtë kontest në asnjë mënyrë nuk pajtohem që të jepen opinione për gjëra për të cilat nuk është vendosur e me këtë dua të them se Komisioni ende nuk ka vendosur për propozimet e emërtimeve të rrugëve.

z. Afrim Shabani, theksoi, duke u bazuar se në vitin 2014 nuk kemi pas Plan pune të Kuvendit, e përshëndes përgatitjen e këtij dokumenti ngase paraprakisht ne këshilltarëve na tregon se çfarë afërisht do të shqyrtohet në Kuvend. Me këtë plan është paraparë një agjendë, mirëpo kjo nuk do të thotë se çështjet e parapara janë fikse dhe nuk do të ketë edhe çështje tjera për shqyrtim.

z. Haki Rudari, theksoi, u përmend komisioni për propozimin e emërtimeve të rrugëve, në parim jam për atë që çdo komision i ngritur nga Kuvendi duhet të paraqet për shqyrtim në Kuvend raport për punën e tij.

Ne Grupi i këshilltarëve i LVV – së, në vitin 2014 kemi kërkuar që Kuvendi të miratoj Planin e punës, unë e kam pas një plan pune të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mirëpo nuk kemi pas përkrahje për këtë.

Këtë propozim të Planit të punës në parim e mbështes por vërehet një mangësi, konsideroj se në janar do duhej të ishte informata për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit aktual shkollor. Pastaj në Planin e punës të Këshillit Komunal për

Siguri në Bashkësi për vitin 2014, i miratuar në Kuvend, në pikën 25 thuhet, informimi i Kuvendit të Komunës dy herë brenda vitit për aktivitetet e KKS-së, kjo nuk ka ndodhë asnjëherë, ky është gabim dhe lëshim i ne këshilltarëve. Jeni në dijeni se unë në mbledhje e kam dënuar vrasjen e një qytetari në zonën kufitare dhe njëkohësisht për atë ngjarje kam kërkuar një informatë nga Kryetari i Komunës, por edhe kjo informatë nuk është paraqitur.

Gjithashtu në këtë plan mungon Raporti i Kryetarit të Komunës për gjashtëmujorin e parë 2015, konsideroj se edhe kryetari i Komunës të duhet të raportoj ashtu siç raportojnë kryetarët e komunave të tjera.

z. Naim Çunaku, theksoi, më vjen mirë që më në fund e kemi një propozim të Planit të punës të Kuvendit për vitin e ardhshëm kalendarik. Gjatë debatit u tha se kemi pas plan pune, nuk kemi pas plan pune, për sqarim kemi pas orar të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit por asnjëherë nuk kemi pas plan pune. Për realizimin apo mosrealizimin e planit të punës, tani nuk mund të diskutojmë por këtë mund ta bëjmë në të ardhmen.

Një plan pune i këtillë është kërkuar edhe më parë dhe është arritur që të bëhet një propozim i planit për të cilin nuk pretendoj se është në nivelin e duhur, përse e them në nivel ngase një plan pune i Kuvendit nuk mund të bëhet derisa nuk kemi programin dhe planin e punës të Ekzekutivit, sikur t'i kishim këto sigurish ne në harmoni me synimet e tyre do të bënim një plan pune më të gjerë dhe më të specifikuar.

Kolegët gjatë debatit disa herë than se kemi dobësi ngase nuk kanë paraqitur raporte ky apo ai, përse nuk janë bërë raportimet përkatëse neve askush nuk na ndalon t'i bëjmë vërejtje bartësve të atyre institucioneve të cilat nuk i përmbushin obligimet sipas përgjegjësisë së tyre, mirëpo sot vërejtjet e tilla janë të vonuara.

Kolegu nga radhët e LVV – së, paraqiti vërejtje për atë që në plan pune nuk është paraparë informata për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor, unë konsideroj se ky plan pune nuk është i mbylltë dhe përfundimtar, nga kjo edhe kolegu i përmendur edhe të tjerët mund të propozojnë çështje të ndryshme dhe në këtë mënyrë pasurohet dhe kompletohet ky plan pune.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, në mënyrën më të sinqertë e them se do të më vinte keq të them se Kuvendi i Komunës deri në vitin 2014 nuk ka pas plan pune ngase për me funksionuar një familje me pesë anëtarë duhet të projektoj se çfarë do të bëjë brenda një viti.

Në diskutimin e mëparshëm unë fola për obligimet e Kryetarit të Komunës në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, pra për disa obligime të pa përmbushura.

Pajtohem me z. Naim Çunaku që të bëhen propozime për plotësimin e këtij plani, por jam i mendimit se edhe nëse bëhen ato propozime nuk do të miratohen ngase opozita nuk i ka numrat e votave të nevojshme.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, pajtohem se në vitet e mëparshme e kemi miratuar vetëm orarin e mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit, por realisht i kemi shqyrtuar kryesisht çështjet të cilat janë në propozimin e këtij plani të punës ngase nuk kemi mundur t'u shmangemi obligimeve që i kemi ndaj qytetarëve tanë. Konsideroj se ky plan pune është në nivel, por nëse ndokush ka propozime konkrete mund të ndryshohet dhe plotësohet, kuptohet në Kuvendin e Komunës.

z. Haki Rudari, propozoi që në plan pune të përfshihen:

- Informatë për gjendjen në arsim, janar 2015

- Informatë e Kryetarit të Komunës për gjendjen politike dhe të sigurisë në Komunën e Podujevës.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, këtë material e kam hartuar në bashkëpunim me të gjithë drejtorët e Drejtorive të Komunës, temat e parapara janë propozuar dhe materialet do të përgatiten nga Ekzekutivi, dhe në rast se nuk veprohet sipas afateve të parapara atëherë do të dihet në mënyrë konkrete se kush e bartë përgjegjësinë.

z. Naim Çunaku, theksoi, jemi duke debatuar për planin e punës dhe as sot e as nesër nuk i ndalohet askujt që për ndonjë çështje për të cilën konsideron se është në interes të propozoj dhe nëse mbështetet propozimi ajo çështje bëhet pjesë e planit të punës. Përndryshe askush këshilltarëve nuk ua ndalon që me rastin e miratimit të rendit të ditës të propozojnë çështje të caktuara për shqyrtim.

z. Kadri Avdiu, theksoi, në diskutimin tim unë thash se pas 14 viteve, përveç orareve për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit, për herë të parë e kemi planin e punës të Kuvendit, apo të jem më qartë prej se unë jam këshilltar i Kuvendit të Komunës nuk ka pas një plan të tillë, edhe pse këtë e kemi kërkuar në shumë raste, po ashtu për shumë ngjarje kemi kërkuar raporte përkatëse mirëpo nuk është raportuar për çështjet e kërkuara.

z. Mynavera Abdullahu – Krasniqi, theksoi, jam e mendimit se diskutimi lidhur me këtë çështje është orientuar në mënyrë jo të mirë ngase a ka pas plan pune të Kuvendit deri më tash apo jo për këtë ekziston dokumentacioni përkatës, andaj konsideroj se diskutimi duhet të orientohet në propozimet të cilat do ta pasuronin këtë plan pune dhe nëse mbështeten do të inkorporohen në këtë dokument.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, konsideroj se diskutimet duhet të bëhen në mënyrë konkrete, në rend dite është propozimi i planit të punës së Kuvendit, andaj gjithë diskutimi duhet të jetë në propozimin e çështjeve konkrete, ndërsa çështjet tjera mund të debatohen kur të jenë në rend të ditës.

z. Naim Çunaku, theksoi, më bëri përshtypje ajo që u përmend nga disa diskutues se a kemi pas apo nuk kemi pas plan pune të Kuvendit, lidhur me këtë çdo njëri prej neve e ka të drejtën të shkoj në arkivin e Komunës dhe në cilësinë e këshilltarit të Kuvendit të kërkoj çfarëdo dokumenti dhe atë prej vitit 2000, kur ka filluar të funksionoj Kuvendi, fundja nëse jeni kurreshtar të dini është e vërtetë se deri në vitin 2007, kur janë bërë ndryshime në legjislacionin për funksionimin e Pushtetit lokal, drejtorët e Drejtorive të Komunës kanë paraqitur objektivat dhe planin e punës për vitin përkatës kalendarik, ndërsa prej atij viti e këndeje nuk kemi plan pune të Kuvendit.

z. Haki Rudari, theksoi, është e vërtetë se unë jam për herë të parë në përbërjen e Kuvendit të Komunës, por për mendimin tim debati është vlerë, andaj nuk pajtohem me mendimin e diskutuesve të cilët thonë se është mirë që është përgatitur ky propozim i planit, pajtohem se është mirë por do të ishte më mirë që të debatohet në mënyrë më konstruktive dhe të pasurohet ky plan, pra nuk duhet kursyer debatet nga propozimet e ndryshme.

Pas votimit u konstatua se me shumicë votash përkatësisht 9 vota për, dhe dy vota kundër propozimi i këtij planit të punës, Kuvendit i rekomandohet për shqyrtim.

4. Marrja e vendimit për kompensimin e Komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc

Fillimisht duke u bazuar se z. Kadri Avdiu dhe z. Haki Rudari janë anëtarë të Komisionit të cekur, për shkak të konfliktit të interesit, përkohësisht u larguan nga mbledhja.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, jam i mendimit se ky Komision e ka kryer një punë të mirë dhe i ka përfunduar punët në përcaktimin e përfituesve për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc dhe atë për fazën e parë dhe të dytë dhe jam i mendimit se kanë vendosur në mënyrë të drejtë, unë jam për atë që jo 250 €, siç propozoj kryesuesi, por të kompensohen me një shumë më të larë, mirëpo nuk jam në dijeni se a ka mundësi buxhetore.

Konsideroj se kryetari i këtij Komisioni para se të shtron kërkesën për kompensim është dashur që paraprakisht të paraqet raportin për punët e kryera, e kjo nuk vlen vetëm për këtë komision por për të gjitha komisionet e ngritura nga Kuvendi.

z. Naim Çunaku, theksoi, konsideroj se është e domosdoshme, ajo që e tha kryesuesi në fjalën hyrëse, që sa më parë të miratojmë një akt me të cilin do të rregullohej mënyra se si duhet të funksionojnë Komisionet e ngritura nga Kuvendi ngase jemi në një situatë jo të mirë sa i përket komisioneve të ngritura nga Kuvendi. Ne kemi qenë në një trajnim të organizuar nga Instituti i Vetëqeverisjes Lokale dhe me atë rast kemi vërejtur një laramani se si kompensohen në komuna të ndryshme komisionet e ngritura nga Kuvendi.

Në parim jam për atë që nuk mund të ketë komision të ngritur nga Kuvendi dhe të mos ketë kompensimin përkatës ngase fundja kjo është mënyra e funksionimit në gjithë botën e civilizuar, në këtë mënyrë funksionon edhe Niveli qendror dhe është një diskriminim i paparë që është duke iu bërë Nivelit lokal. Nëse sipas ligjit kërkohet që të ngritet një komision nga këshilltarët e Kuvendit dhe të kërkosh punë prej tij e të mos bësh kompensimin përkatës, kjo është jashtë çdo norme normale.

U përmend shuma e kompensimit për komisionin dhe se për lartësinë e kompensimit të vendos Kuvendi, unë jam kundër një mënyre të këtillë ngase për të funksionuar e në rastin konkret jam i informuar se i kanë mbajtur së paku 30 takime dhe pagesa të bëhet pas 6 muajve konsideroj se nuk është në rregull, pa e harruar faktin nëse duhet të kalohen 20 km. rrugë për të marrë pjesë në punën e atij komisioni, të jemi real se ndokush mund të jetë në situatë të pamundësisë për pjesëmarrje në punën e komisionit.

Nuk kam dilemë se a duhet të mbështetet në aspektin financiar ky Komision andaj çdo propozim për mua është i pranueshëm.

z. Afrim Shabani, theksoi, jam i mendimit se çdo këshilltar i Kuvendit të Komunës i cili është anëtar i ndonjë komisioni duhet të kompensohet për punët që i bënë në komisionet përkatëse, por gjithherë duke pas përsyshë se çdo komision e ka rëndësinë e vet. Në bazë të bisedave dhe informacioneve që i kam pas me disa anëtarë e në veçanti me kryetarin e Komisioni për ndarjen e shtëpive në lagjen e Dëshmorëve jam në dijeni se kanë pas probleme jo vetëm verbale por edhe fizike. Sa i përket lartësisë së kompensimit, sa unë jam në dijeni mëditja për një mbledhje është 50 €, mirëpo pasi ne nuk e kemi të miratuar Rregulloren me të cilën do të

përcaktohej shuma e kompensimit konsideroj se në rastin konkret do duhej të merret një mesatare e pagesës.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, të gjithë jemi në dijeni se Komisioni për ndarjen e shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve e ka kryer një punë mjaftë të vështirë dhe sado që të jetë shuma e kompensimit nuk do të kompensohen për gjithë punën e kryer, mirëpo ne në radhë të parë duhet t'i shikojmë mundësitë tona buxhetore. Propozimi im është, po e përsëris nëse ka mundësi buxhetore, kompensimi të jetë 400 €.

Pas propozimeve në formë dialogu dhe votimit u konstatua se Kuvendit njëzëri i rekomandohet që Komisioni për ndarjen e shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve, për punën e kryer të kompensohet në shumë 300 €.

5. Të ndryshme

z. Afrim Shabani, theksoi, unë dhe dy këshilltarë të Kuvendit jemi anëtarë të Komisionit vlerësues për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, i ngritur nga Kuvendi i Komunës, Komision i cili vërtetë ka përgjegjësi dhe ne kemi kërkuar kompensim për punët e kryera, mirëpo deri tash nuk kemi marr kurrfarë përgjigje. Qëllimi im është që ndonjë anëtar të mos shpreh pakënaqësi për shkak të mos kompensimit e me këtë edhe mospjesëmarrje në punën e Komisionit të cekur, andaj jam i interesuar të di se a ekziston ndonjë formë zgjidhjen e kësaj çështjeje.

z. Mehmet Gashi, theksoi, për çështjen e kompensimit të komisioneve të ngritura nga Kuvendet e Komunave, kemi premtime nga niveli qendror se do ta nxjerr një Udhëzim administrativ dhe nëse nuk nxirret Udhëzimi i cekur, atëherë ne do ta obligojmë Zyrën ligjore të përgatit propozimin e Rregullores përkatëse me të cilën do të përcaktohet mënyra e kompensimit të anëtarëve të komisioneve të ngritura nga Kuvendi i Komunës.

Mbledhja përfundoi në orën 15.00'

Procesverbalin e mbajti

Faik Gashi

Nr. 01- 006-101683

**Podujevë,
29 dhjetor 2014**

**Kryesuesi i Komitetit
Mehmet Gashi**